



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJORË MAT

Vendim

Nr. 5 Date 22.02.2017

Per

Dhënie mendim për përdorim të rezervës ujore për energji elektrike për HEC “Daznjane”, Përroi Daznjane , degë e Lumi Mat/ Subjektit “Aris Albania” sh.p.k

- Në mbështetje të nenit 7 pika 2, të nenit 50, 51 dhe nenit 52 ligjit nr 111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, vendimin nr.416 datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “ Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe Leje për përdorim të burimeve ujore”, si dhe nenit 24 të Vendimit të KM nr. 822, date 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, me propozim të A.U.B. Mat

Këshilli i Basenit Ujor Mat,

Vendosi:

1-Miratimin në parim të kërkesës së “ Aris Albania” shpk, me Administrator Z. Adrian Rama, për “Përdorim Rezerva Ujore për Energji Elektrike “ sipas studimit të paraqitur nga subjekti “Aris Albania” shpk, me keto të dhena:

HEC “Daznjane”

-Prurja mesatare : $Q=0.185 \text{ m}^3/\text{sek}$,

-Prurja llogarites: $Q= 0.397\text{m}^3/\text{sek}$,

-Prurja ekologjike: $Q= 0.031\text{m}^3/\text{sek}$,

-Prurje për përdorime të tjera: _____ m^3

-Energjia e planifikuar vjetore: 5 625 920kwh/vit,

-Fuqia 1675 kw, 3358 ore punë/vit

- Kuota e aksit të vepres së marrjes: Z- 891m.n.d X – 44 25 826.47 Y- 46 16 201.26

-Kuota e godines së centralit: Z-355 m.n.d X – 44 24 028.59 Y- 46 14 332.73

2- Nuk lejohet ndryshimi i regjimit të vaditjes, i furnizimit me uje të popullatës etjere nga përdorimi i ujit për energji elektrike.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjehere.

PERGJEGJESI I A.B.U. MAT

Ast **NIKOLLA**



KRYETARI I K.B.U.MAT

Eduard NDRECA

